

## KËRKIME GJUHËSORE

Arta MALSHI

### VËZHGIME RRETH TË FOLMEVE TË MIRDITORËVE TË FSHATRAVE PLLANË E ZEJMEN TË RRETHIT LEZHË (Fonetikë-Morfologji)

Posa kalon Urën e Matit, në të dy anët e rrugës që të çon për në Lezhë, ndodhet **Pllana**, fshat që përbëhet nga 4 lagje: *Margegaj, Kodra e Pllanës, Vukaj dhe Kallulli*.

Tri lagjet e para shtrihen në mal dhe vetëm lagjia Kallull shtrihet sa në mal dhe në fushë, deri në kufi me Gajushin. Banorët e fushës së kësaj lagjeje janë relativisht të vonë në krahasim me ata të lagjeve që ndodhen në mal.

Kufi me Pllanën, në vazhdim të rrugës për në Lezhë, ndodhet **Zejmeni**. Shumica e popullsisë së këtyre fshatrave është e përbërë nga vendasit me origjinë nga vise të ndryshme të Mirditës. Të dy fshatrat janë mjaft të vjetër.

Në këtë punim do të përqendrohemi vetëm në veçoritë fonetike e morfologjike të të folmes së vendasve me origjinë nga Mirdita, pasi e folmja e një pjese të banorëve të lagjes Kallull të fshatit Pllanë si dhe një pjesë e banorëve, që kanë ardhur në lagjen e re, në qendër të fshatit Zejmen, nga krahina të ndryshme, përbëjnë një specifikë të veçantë.

Gjuha e banorëve të këtyre dy fshatrave, ashtu si dhe veshja dhe zakonet, gjatë vjeljes së materialit na doli e njëjtë, prandaj i bëmë objekt të një studimi të vetëm.

#### 1.FONETIKA

**Theksi i fjalës.** Dallohen zanoret e gjata:

1. Në rrokje të hapur: *rakē, trē, drū, hū, trā, kalā*, etj.

2. Në rrokje të mbyllur: *hambar, gur, grun*, etj.

3. Tek emrat që mbarojnë me *ē*: *fūshē, mīzē, būrrē*, etj.

Zanoret e gjata vijnë edhe nga monoftongimi i fjalës, siç ndodh tek fjalët: *pnū, ftū, prrū, luftū*, etj.

Zanoret e shkurtra hasen më shumë në rrokje të mbyllur: *kép, kósh, thés, plép, lís*, etj., por edhe në rrokje të hapur tek mënyra urdhërore e foljeve: *rré, shkó, pnó, msó*, etj.

**Zanoret hundore.**I gjejmë para nazaleve: *hūni, hūna, duhân, jorgân, drūni, kërcūni, hīni, pēni*, etj. Si të tilla shqiptohen edhe kur mungon nazalja *n* (*hū, drū, kërcū, hī*).

**Tingujt zanorë.**

1. *U*-ja nuk dëgjohet në mjaft fjalë: *pnu* (punuar), *tinglli* (tingulli), *petlla* (petulla), *vetlla* (vetulla).

2. *i>e* (të hapët): *pē* (pi), *shpē* (shtëpi), *mllē* (mulli), *kushrē* (kushëri), *mēk* (mik), *nēp* (nip), etj.

Shpeshherë, fjalë si këto me *e* të hapët marrin ngjyrë nazale: *mek, mte* (tundës qumështi), *mer, mlle*, etj.

3. Në mjaft fjalë, **Y**-ja nuk ruhet si e tillë, por jep **i** ose **e**: *di* (dy), *lip* (lyp), *disheme* (dysHEME), *gjisë* (gjysma), *shiqir* (shyqyr), *tem* (tym), etj.
4. **O>a**: *kashare* (kosh i vogël), *kalibe* (kolibe), *axhak* (oxhak), *katec* (kotec), etj.
5. Si një fenomen i rrallë, është përdorimi i zanores **u** në vend të **o**-së (**o>u**): *kumunë* (komunë), *kumandë* (komandë), *kullet* (kollitet), etj.
6. **Ë**-ja dëgjohet në pozicion fundor: *mollë*, *dardhë*, *dorë*, *burrë*, *punë*, *javë*, etj. (Në këto raste, fjala ka një zanore të theksuar). Ka raste që **ë**-ja ka rënë në trup të fjalës: *ktu* (këtu), *kto* (këto), *mkat* (mëkat), *lshoj* (lëshoj), *knej* (kënde), etj.

#### Grupe zanoresh.

1. Në këto të folme, grupi zanor **ue** është reduktuar e ka dhënë **u** (**ue>u**). Ky është një fenomen i përgjithshëm, mbase karakteristike kjo edhe për krahinat e tjera të Veriut, p.sh. *pagu* (paguar), *jetu* (jetuar), *knu* (kënduar), *kru* (krua), *ftu* (ftua), *rrerthu* (rrethuar), etj.
2. Grupi zanor **ye** del **i** ose **e** e hapët: *li* (lyer), *tlinë* (tlyen-gjalpë), *kre* (krye- ka krye punë), *the* (thye-ka the qafën), *kce* (kërcyer- ka kce kanal), etj.
3. Grupi zanor **ie** jep **e**: *mell* (miell), *qell* (qiell), *vel* (vjel), *përçell* (përcjellë- shkoi me përçell), por edhe *sjellë*, *bien*, etj.

#### Bashkëtingëlloret.

1. Nuk ruhet gjithmonë bashkëtingëlloret **h**; ajo del shpeshherë **f**: *lef* (leh), *i ftoftë* (i ftohtë), *shifte* (shihthe), *krefte* (krihte), etj., ose ndonjëherë s' dëgjohet fare: *i zetë* (i nxehtë), *i letë* (i lehtë).
2. **Nj/j**: *ftoj* (ftonj), *zojë* (zonjë), *thoj* (thonj), etj. (Ky evoluim ka ndodhur sidomos tek ato fjalë që dikur kanë dalë me **n**: ftoni, thoni, etj.)
3. **Th/f**: *ufulla* (uthulla), *flaza* (thëllëza).
4. **S/c**: *malcur* (malësor), *acosh* (asosh), *cejçili* (secili).

#### Grupet e bashkëtingëlloreve.

1. Grupi **kj** dëgjohet ende në fjalë: *kjamet*, *kjumsht*, *kjanë* (qanë), *kjosha* (qofsha) - "Në kjosha shnosh.....", etj.
2. **Gi**: giuni (gjuri), por shpesh edhe guni, të giata (të gjata), etj.
3. **Mb/m**: *maj* (mbaj), *mloj* (mbuloj), *maroj* (mbaroj), *mledh* (mbledh), *mjell* (mbjell), etj.
4. **Nd/n**: *men* (mend), *nalu* (ndalu), *mun* (mund), *i nershëm* (ndershëm), *hanek* (hendek), *knova* (këndova), *katunar* (katundar).
5. **Fsh/sh**: *kosha* (kofsha), *martosha* (martofsha), *qosh* (qofsha), *shkosh* (shkofsh), etj.
6. Grupi **msh** dëgjohet në fjalë si: *mshi* (fshi), *mshel* (mbyll), *mshef* (fsheh), etj. (**fsh/msh**).
7. Grupi **fl** dëgjohet në fjalë si: *kam flet* (fjetë) (**fj/fl**).

#### Disa fenomene më të rëndomta fonetike

1. Bie në sy fenomeni i metatezës në fjalë si: *pshton* (shpëton), *thkej* (kthej).
2. Bashkëtingëlloret **s**, kur ndodhet përpara një bashkëtingëlloreje okluzive dëgjohet **z** (e zëshme): *z'do të vij*, *z'del*, *z'duhet*.
3. Ka ndonjë shtesë në trup të fjalës, si tek fjala *thkellë* (thellë).

VËZHGIME RRETH TË FOLMEVE TË MIRDITORËVE TË FSHATRAVE  
 PLLANË E ZEJMEN TË RRETHIT LEZHË

4. Grupet **tm, tn**, tek të moshuarit asimilohen në **m, n**: “Kur vom ke shpeja, gjem do miq.....” (“Kur vajtëm te shtëpia, gjetëm ca miq”); po kështu në vetën e tretë shumës: *von, gjen*.

5. Karakteristikë janë rëniet e tingujve nga trupi i fjalës ose në fund të saj: *e epra* (e epërmja), *u njohën me shoshonjë* (shoqishoqin), *mo* (mos), *a* (asht), *kena pa shku* (kemi pas shkuar).

## 2. MORFOLOGJIA

### Emri.

1. Tek të moshuarit ka lëkundje në gjini të disa emrave mashkullorë, të cilët shpeshherë dalin në gjini femërore: borxhja (borxhi) - “Borxhja e vonë gazmon t’zonë”, shnetja (shëndeti), në shprehjet si: “T’majt shnetja”, etj.

2. Emrat e gjinisë asnjansë ndeshen rrallë. Ata kanë kaluar në emra të gjinisë mashkullore, por ka edhe të tillë: t’ftoftit, t’thatit, t’lagtit, (“I prishi t’ftoftit....”) me origjinë nga ndajfoljet ose foljet.

3. Dalin me mbaresën **u** emrat mashkullorë që mbarojnë me **k** (grykore): shoku, miku, plaku, etj. dhe herë me mbaresën **u** dhe herë me **i** emrat mashkullorë që mbarojnë me bashkëtingëlloren **h**: ahu, krah, plehu, por edhe *ahi, krahi, plehi*.

4. Dalin me **o**, në të shquarën, disa emra mashkullorë që kanë qenë me **u** (që vjen nga **ue**): *Noi* (Ndoi), *zgjoi, prroi*, etj.

5. Emrat e gjinisë mashkullore që në të pashquarën mbarojnë me **ull**, kur shquhen me mbaresën **i**, dalin herë me **ull** e herë me **oll**: Prull (fshat kufi me Zejmenin), *trulli, shulli*, por edhe: *Prolli, trolli, sholli*.

6. Disa emra në rasën kallëzore me parafjalë marrin një **t** në fund: n’malt, n’bregt, “Për fillet penit pshtoi”, “Për birt gjilpans kaloi”, “n’dort ati je”, etj.

7. Në të dy fshatrat, rrallë ruhet, si në Shkodër, trajta me **et**: “shtrigë shtriget”, kalë karrocet”, “tamël lopet”.

8. Një shumicë emrash që mbarojnë me bashkëtingëllore, ndryshe nga gjuha e sotme letrare, e formojnë shumësin me mbaresën **a**: *nanpunca, oficera, msusa, gishta*, etj.

9. E formojnë shumësin me **e** emrat: *kanale, vorre, zakone, male, katune*, etj.

10. Disa emra të gjinisë mashkullore i palatalizojnë bashkëtingëlloret grykore **k, g** në **q, gj** në shumës: *fturk-fturq, zog-zogj*; disa marrin edhe mbaresën **e**: *kanak-kanaqe, trung-trungje*. Disa të tjerë, krahas palatalizimit, e formojnë shumësin edhe me metafoini: *plak-pleq, tra-trenë, lak-leqe*, etj.

11. Në disa raste, formimi i shumësit bëhet jo vetëm me mbaresë, por edhe me zgjatje të zanores në trup të fjalës: *dallap-dallapë, vath-vathë*, etj.

12. Emrat: *kalë, djalë* dalin në shumës: *kolt, djelmt*.

13. Është karakteristike dhanorja me **et**: *djelmet, gravet* (I çova fjalë djelmet), rrjedhorja me **sh**: *sysh* (A t’ra për sysh)

### Përemri.

\* Përemri vetor **ti** përdoret **te**.

## ARTA MALSHI

\* Përemri pronor **i imi** përdoret **i emi, e emja, tem**: “Asht i emi, e emja....”, (ndonjëherë **e jemja**), shpeja eme, vllan tem.

\* Pronori **yt** përdoret **it** (meku it).

\* Te pronorët u vërejtën edhe këto trajta karakteristike: **tan** (tënd) -“Pashë shokun *tan, tuj* (tuaj)”, “Rreni n’pun *tuj*”, *juj (juaj)* -“A puna *juj* kjo”; e juja (tuaja) -“Fjalt e juja”.

Konstatohen edhe kalime të tilla në gjini: veni jonë (vendi ynë), ato burra (ata burra).

### Folja.

#### Mënyra dëftore

1. Në vetën e II shumës të kohës së tashme vërehet metafonizmi i **e>i**: *mbledh-mblidhni, mbjell-mbillni, tjerr-tirrni*.

2. Në të pakryerën nuk është karakteristike mbaresa **ja**, por **sha**: *rritsha, kapshe, rasha, dosha, lusha*, etj.

Veta e II: *rritshe, kapshe, rushe, doshe, lushe*.

Veta e III: *rritte, kapte, dote, lute*.

3. Në të kryerën e thjeshtë ruhet mbaresa **ë**: *thashë, lashë, rashë, pashë*, etj. Metafoni (**e>o**): *mel-mola, vel-vola, mbjell-molla, tjerr-tora*, etj.

4. Dalin edhe ndërtime të tilla: “Jam tu punu” (po punoj), me vlerën e kohës së tashme që për nga kuptimi shpreh vazhdimësi veprimi. “Ishte tu kosit” (po kosit), me vlerën e të pakryerës që, gjithashtu, shpreh vazhdimësi veprimi.

5. Kohë më se e kryer: “Kan pa marr fushën”, “Kishte pa ken shitu”, etj.

6. Në vlerën e kohës së ardhme dalin ndërtimet: “Ka për t’kenë ate” (do të jetë aty), “Ka me shku n’Milot” (do të shkojë në Milot).

**Mënyra lidhore.** Në përgjithësi, ruhet pjesëza **t**: “Kur t’kem terezi, kam me ardh”, por edhe **a**: “A mun vish, a mun hecish, a mun presish, a mun mahe, etj. (pa pjesëz përpara, kur mënyra lidhore paraprihet nga një folje gjysmëndihmëse, që tregon mundësi).

**Mënyra urdhërore.** Folje të kësaj mënyre dalin me një trajtë të shkurtër të përemrit vetor **i**: *mlidhi, merri, mshili* (mlidhi petkat ngardh, mshili delet, etj.).

**Diateza pësore.** Ka si karakteristike mbaresën **e**, në vetën e II.

Koha e tashme: *gzohe, lahe, msohe*, etj. (*gëzohesh, lahesh, mësohesh*), ndërsa në shumës dalin me mbaresën **na**: *gzohna, lahna, msohna* (veta I).

**Parafjala.** Në rasën emërore, në vend të parafjalës **te, tek** përdoret parafjala **ke** (ndonjëherë edhe **ku**): *ke (ku) stani, ke (ku) ara*, etj.

Në rasën kallëzore përdoret parafjala **m**: *m’at anë, m’at qosh*.

Në rasën rrjedhore përdoren edhe parafjalët **mrena - jashtë**: *mrena deret, jashta deret*, etj.

Gjatë vëzhgimeve të bëra, tek e folmja e brezit të vjetër, kemi konstatuar, gjithashtu, se veçanërisht tek brezi i ri gjuha letrare kombëtare e njësuar është një realitet. Ajo po ndikon fuqimisht duke i zhveshur dalëngadalë këto të folme nga veçoritë e tyre dalluese dhe po përdoren çdo ditë e më shumë trajtat e gjuhës letrare.